

KËRKIME GJUHËSORE

Eneida MATAJ

RRETH KATEGORISË GRAMATIKORE TË ASPEKTIT NË SHQIPE DHE GREQISHTE

Fillimi i studimit të aspektit nga shumë studiues të ndryshëm mendohet se lidhet me shkollën e stoikëve, të cilët vunë re së pari se krahas kohës, ka edhe një faktor tjetër shumë të rëndësishëm që përcakton trajtën e foljes greke dhe pikërisht rrethana, nëse trajta përcaktuese e foljes shpreh një veprim të kryer apo një veprim të pakryer. Prirja për të përfshirë në kategorinë e aspektit të gjitha karakteristikat e veprimit foljor të pavarura nga koha ka qenë në përgjithësi tipike për periudhën e hershme të studimit të këtij problemi. Këtë pikëpamje e kanë mbrojtur edhe një varg i tërë studiuesish e gramatikanësh deri në kohët më të reja.

Atë e gjejmë dhe tek Aristoteli, në ndarjen që ai u bën veprimeve foljore në cakësore/jocakësore, dhe në dallimin e formave foljore, për nga tiparet aspektuale.

Aristoteli që ai i cili vuri në dukje shenjimin e kohës, që është vetëm një pjesë e funksionit semantik kohor të foljeve në greqishten e vjetër. Në shenjimin e kohës ndërthuren dy përmasa: koha e ngjarjes dhe forma e kryer, e pakryer ose e vazhduar e veprimit.

Me këto dy kategori të veçanta të katër kohët mund të paraqiten si më poshtë.

Koha

Aspekti

E tashme E shkuar

I pakryer E tashme E pakryer

γράφει “shkruan” εγράφει “shkruante”

I kryer E kryer Më se e kryer

εγράφη “ka shkruar” εεγράφει “kishte shkruar”

E ardhmja (μέλλον, μέλλων, grapsei, γράψει) dhe aoristi (i thjeshtë, ‘i pacaktuar’ nga pikëpamja e aspektit, i shkuar, αόριστος, αόριστος, εγραφσε, έγραψε “shkroi”) nuk hyjnë në këtë sistem simetrik, prandaj u konsideruan të papërcaktuar, mëllon në lidhje me të ardhmen, αόριστος me të shkuarën; edhe ngjashmëria morfologjike e temës për shumë forma të së ardhmes dhe të aoristit mund të ketë ndikuar për një interpretim të tillë semantik¹. E ardhmja e kryer u

¹ Bekker, Anecdota Graeca, vëll. I, f. 890-891; Steinthal, Geschichte der Sprachwissenschaft bei den Griechen und Römern, vëll. I, f. 307-317; Varëick, Probleme der stoischen Sprachlehre und Rhetorik, f. 51.53.

kundrua si një veçanti e dialektit atik, me përdorim të kufizuar edhe atje². Vepra e gjuhësore e stoikëve u vazhdua nga dishepujt e shkollave filozofike stoike gjatë gjithë Lashtësisë. Por, në historinë e gjuhësisë, ndryshimet që studiuesit aleksandrinë u bënë qëndrimeve të stoikëve e çuan këtë lëndë, veçanërisht çështjet gramatikore të saj, në pikën në të cilën këtë traditë e rimorën gramatikanët latinë, të cilët ia përcollën traditës europiane.

Vepra e gjuhësore e stoikëve u vazhdua nga dishepujt e shkollave filozofike stoike gjatë gjithë Lashtësisë. Por, në historinë e gjuhësisë, ndryshimet që studiuesit aleksandrinë u bënë qëndrimeve të stoikëve e çuan këtë lëndë, veçanërisht çështjet gramatikore të saj, në pikën në të cilën këtë traditë e rimorën gramatikanët latinë, të cilët ia përcollën traditës europiane.

Lidhur me aspektologjinë u hodhën disa pikëpamja si:

1. Pranohet si aspekt korrelacioni i trefishtë të së tashmes, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës në greqishten e vjetër si dhe në disa gjuhë të tjera evropiane .

2. Karakteri binar {dygjymtyrësh}i kryer / i pakryer {në gramatikën e studiuesit cek}etj.,

Si dhe pikëpamja të tjera që trajtohen më poshtë:

3. Ekziston edhe mendimi se aspekti është një kategori universale, të cilën në një mënyrë ose në një tjetër e kanë të gjitha gjuhët.

Por në rastin e aspektit nuk duhet harruar gjëja më e rëndësishme, karakteri binar, dygjymtyrësh, i kësaj kategorie. Së dyti, nuk është aspak e lehtë të përcaktohet karakteri i kësaj ngjashmërie funksionalo-semantike, d.m.th. të përcaktohet çfarë tiparësh funksionalo-semantike kanë pikërisht të përbashkëta tërë kategoritë e lartpërmendura, ç'ka na lejon t'i bashkojmë ato në konceptin e aspektit. Sepse në çdo rast është fjala për mënyra të ndryshme përfytyrimi të ecurisë së veprimit.

Një studim i hollësishëm dhe i argumentuar për aspektin e aq më pak për mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe deri më sot mungon .Në përgjithësi në studimet gjuhësore shqiptare (me ndonjë përjashtim) ka zotëruar pikëpamja se të gjitha karakteristikat e veprimit foljor duhet të përfshihen në konceptin e aspektit, ndërsa për mënyrat e veprimit, bëhet fjalë për herë të parë në "Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe"³.

Me këtë problem për herë të parë është marrë K. Çipoja ai jep një përkufizim me të cilin synon t'i përfshijë të gjitha karakteristikat e veprimit foljor brenda konceptit aspekt. Foljet i ndan në dy kategori të mëdha: folje me aspekt të

² Bekker, Anecdota Graeca, vëll. II, f. 891-892 (Gramm. Graeci, I, 3, f. 250-251); C. H. Versteegh, The Stoic Verbal System, në "Hermes", CVIII (1980), f. 338-355, bën së fundi një rishqyrtim të përmbledhur të analizës gjuhësore të stoikëve për sistemin foljor të kohëve në greqishten e vjetër me vlerësime kritike për interpretimet e para dhe një krahasim me Varronin dhe traditën kryesore gramatikore latine për foljet e latinishtes.

³ Fonetika dhe Gramatika , f. 225-226Ç

RRETH KATEGORISË GRAMATIKORE TË ASPEKTIT NË SHQIPE DHE GREQISHTË

zgjatur ose të vazhduar ose folje me veprim vijë dhe folje me aspekt të çastësisë ose folje me veprim pikë.

S. Floqi ai ka analizuar ndërtime foljore që shprehin përsëritje, shkurtësi, theksim ose çastësi të veprimit pa folur as për aspekt as për mënyrë veprimi.

E. Lafe në një artikull të tij vështron aspektin në një kuadër më të gjerë, duke përfshirë në të si forma gramatikore të një foljeje, ashtu edhe kuptime të foljeve të ndryshme, më vonë ai pohon se shqipja nuk e ka kategorinë e aspektit.

Sh. Demiraj nuk është shprehur në mënyrë të qartë nëse e pranon kategorinë e aspektit në foljet e shqipes.

Me çështjen e aspektit në gjuhën shqipe janë marrë edhe disa studiues të huaj. A. Desnickaja ka theksuar se gjuha shqipe nuk e ka kategorinë e aspektit. Kuptimet aspektore shoqërojnë në një fare mase kuptimin e kohëve. Format e së tashmes dhe të së pakryerës shprehin gjithmonë veprime të zgjatura, ndërsa e kryera e thjeshtë veprime të shkurtra që janë përfunduar prkt. veprime të shkuara që vështrohen jashtë lidhjes me kohën e zgjatjes së tyre.

Desnickaja shton se në gjuhën shqipe kemi të bëjmë me dallimin aspektor-kohor edhe te dallimi i temës së tashme (veprim i zgjatur), nga njëra anë, dhe i temës së të kryerës së thjeshtë (veprim i shkurtër), nga ana tjetër⁴. Por një dallim i tillë shfaqet vetëm brenda sistemit të ndërtimit të formave të së njëjtës folje, ndërsa në fjalëformim kuptimet aspektore nuk luajnë ndonjë rol. Prandaj ato edhe nuk gjejnë ndonjë pasqyrim.

Kështu prapashtesat janë mjete që shërbejnë për të ndryshuar kuptimin leksikor dhe jo mjete perfekte.

Për këtë mjafton të krahasojmë përdorimin e së tashmes dhe të së pakryerës së foljeve që shprehin fillim ose përfundim të veprimit. Ndërsa format e së tashmes së këtyre foljeve shprehin fillimin, përfundimin ose përsëritjen e veprimit, të dytat shprehin përfundimin ose përsëritjen e tij. P. sh.: ...

ashtu si mbulohet prushi me hi, të cilin me ta ngacmuar, **zë** e shkëlqen përsëri (A. Abdihojha, Një vjeshtë, f. 18)⁵; Ndërkaq e kryera e thjeshtë fare mirë mund të tregojë veprime të zgjatura, p.sh.: Për trikotazhin **punove** tre vjet (A. Abdihojha, Dueli, f. 10)⁶; Prandaj, edhe pasi e shkroi, ai e **mbajti** pesë vjet dorëshkrimin (V. Bala, Jeta, f. 32)⁷.

E pakryera shpreh gjithmonë një vështrim të pakryer, ndërsa e kryera e thjeshtë shpreh një veprim të kryer⁸.

Prof A. Dhrimo aspektin foljor e paraqet si një pikë vrojtimi, prej së cilës kundrohet një veprim, proces a ngjarje gjatë rrjedhës në kohë, por jashtë lidhjeve të veta me çastin e ligjërimit dhe pa lidhje me rrethanat ligjërimore. Që këtë del se

⁴ A. Dhrimo, Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, vep. e cit., f., 21-22.

⁵ A. Dhrimo, Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, vep. e cit., f. 21.

⁶ Shih, A. Dhrimo, Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, vep. e cit., f. 22.

⁷ Shih, A. Dhrimo, Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, vep. e cit., f. 22.

⁸ Serebrenikov, vep. e cit., f. 26.

aspekti pasqyron qëndrimin subjektiv, perspektivën subjektive të folësit ndaj veprimit. Dy aspektet nuk formojnë çifte fjalësh, por formash, pra, elementet e tyre formuese shikohen si gramatikore, pra, si formëformuese, jo si, fjalëformuese. Në rastin e aspektit rëndësi vendimtare ka pikërisht qëndrimi i folësit, këndvështrimi i tij, nën të cilin ai e kundron veprimin, dhe jo përmbajtja leksikore e foljes. Kjo e fundit nuk luan ndonjë rol, nuk merret fare parasysh nga folësi. I njëjti proces kapet dhe shikohet çdo herë ndryshe nga folësi prkt. shkruesi.

Pikërisht kjo mënyrë të kapuri prkt. të shikuarit të veprimit quhet aspekt. Dhe pikërisht kjo mënyrë subjektive e të sodituri nga folësit a vrojtuesit, karakteri subjektiv i aspektit ka bërë që ai shumë herë të përfshihet në mjetet stilistike. Kjo ndodh sepse është e vërtetë që përfundimi i vrojtimit subjektiv të rrjedhës së veprimit mund të shprehë gjuhësisht një stilizim të caktuar të procesit. Aspekti bën pjesë në gramatikë ashtu si gjithë kategoritë e tjera subjektive të foljes, pavarësisht se ku dhe si gjen përdorim në ligjërim. Karakteristika kryesore e aspektit në rrafshin funksional e kuptimor është, pra, mënyra se si paraqitet në kohë rrjedha e veprimit. Në një vështrim të gjerë folësi mund ta paraqesë atë në rrjedhje e sipër ose si rezultat, si një të tërë, të përmbledhur.

Që këtë del se folësi mund të vendoset brenda veprimit dhe të shikojë vetëm që ai rrjedh, pa pasur asnjë ide për fillimin dhe fundin e tij, ose, përkundrazi, ta kundrojë atë nga jashtë dhe kështu tërë ecuria e tij, nga fillimi deri në fund, zhvillohet përpara syve të tij.

Parimisht të dy pikëpamjet, të dy mundësitë e vështrimit janë plotësisht të mundshme, por në rrethanën e dhënë ligjërimore për disa prkt. për secilin veprim, këndvështrimi nën të cilin ai kundrohet ose mënyra e vështrimit është e prerë dhe kjo përbën atë që e quajnë objektive tek aspekti. Është e drejtë të theksohet se edhe aspekti, ashtu si edhe disa kategori të tjera gramatikore, nuk është plotësisht i pavarur nga kuptimi leksikor. Ky i fundit kushtëzon pikërisht atë, nëse një folje e dhënë mund të formojë çift aspektor apo ka vetëm njërin nga aspektet. Që këtë del se çdo formë foljore i përket pjesës së një aspekti të caktuar, por jo çdo folje e dhënë i ka të dy aspektet.

Në gjuhën greke temat që kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve e shumë studiuesve janë koha e foljes dhe aspekti foljor (ρηματική όψη), si dhe lidhjet e këtyre dy kategorive foljore. Mund ti referohemi Xarxanos (Τζάρτζανος) (1932, 1934) dhe Andriotit (Ανδριώτης) (1932, 1934) të cilët shprehën pikëpyetjet e para në lidhje me ekzistencën e lidhore në gjuhën e re greke. Më pas kjo ide u zhvillua nga një plejadë shkrimtarësh të cilët prireshin nga ideja e mos pranimit të dallimit midis mënyrës dëftore dhe asaj lidhore tek folja, që është e dukshme në gjuhën antike greke, mënyrën e veprimit perfekt (τέλειου / μη εξακολουθητικού) dhe imperfekt (μη τέλειου /εξακολουθητικού) e cila sigurisht që pasqyrohet më mirë në gjuhën e re greke⁹.

⁹ P. Mackridge, 1985. *Η Νεοελληνική Γλώσσα*. Περιγραφική ανάλυση της νεοελληνικής κοινής. Μετάφραση Κ. Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα, σελ., 169-170.

RRETH KATEGORISË GRAMATIKORE TË ASPEKTIT NË SHQIPE DHE GREQISHTE

Studiuesi Mirambel (Μιραμπέλ) në studimet dhe publikimet e tij ka theksuar se dallimi i mënyrës së veprimit është mbizotëruese dhe nga dallimi i kohës së foljes. Mendimi i tij (1956: 219) është se: në shkallëzimin e vlerave të foljes në gjuhën greke në mënyrë hierarkike aspekti i foljes së vendin kryesor dhe pas saj renditen trajta, mënyra dhe në vend të fundit koha¹⁰.

Në gjuhën greke aspekti është një kategori dyshe. Aspekt foljor gramatikor emërtojmë këndvështrimin nga i cili folësi kundron një ngjarje në lidhje me përbërjen e brendshme kohore : ose në mënyrë të përmbledhur, pra pa u interesuar për përbërjen e brendshme kohore, ose duke dhënë informacione lidhur me të¹¹. Të dyja këto kategori gramatikore, të kohës dhe të aspektit të foljes, shprehen morfologjikisht tek trajta e foljes.

Studiuesi G. Babinioti për foljen në gjuhën greke pranohen dy aspekte. Kundërvënja mund të jetë midis dy aspektesh, midis dy formave aspektore: aspekti imperfektiv dhe aspekti perfektiv, përkatësisht aspekti i pakryer dhe aspekti i kryer, dhe foljet përkatëse quhen imperfektive (të pakryera) dhe perfektive (të kryera)¹². Në qoftë se një veprim e shprehim me një folje të pakryer, fjala vjen γράφω "shkruaj", atëherë ne jemi vendosur brenda veprimit. Përmasat e tij, fillimin dhe fundin, ne nuk mund t'i shikojmë, pra për ne mbeten të panjohur. Si pasojë ngjarjen a veprimin e shprehur nga folja ne nuk e rrokim dot si një të tërë, të përmbledhur. Këtë rrethanë mund ta krahasojmë me një parakalim. Në rast se veprimin ne e shprehim me një folje të pakryer, jemi si ai "pjesëmarrësi i veçantë i parakalimit" i cili "nuk shikon as fillimin e as fundin e kolonës që parakalon pa pushim, sepse ai vetë ndodhet në rrjedhën e njerëzve"¹³.

Në qoftë se ne përkundrazi do ta shprehim veprimin me një folje të kryer, atëherë ne e shikojmë veprimin si diçka tërësore, të përmbledhur. Në këtë rast ne jemi jashtë ngjarjes dhe e shikojmë atë si diçka tërësore, e rrokim në tërësinë e saj.

Aspekti në gjuhën greke është një nga nocionet kryesore që përdor folësi në komunikimin e tij. Kohët e foljes përbëjnë një kategori themelore, dhe në kombinim me trajtat paraqet një shumëllojshmëri morfologjike të gjerë. Koha është një nocion i ndërlikuar i cili mund të paraqitet në forma dhe këndvështrime të ndryshme. Shfaqja e kategorive të ndryshme kohore mund të bëhet me mjete gjuhësore ose gramatikore. Gjuha greke shpreh me mjete gramatikore dy nga

¹⁰ P. Mackridge, 1985. *Η Νεοελληνική Γλώσσα*. Περιγραφική ανάλυση της νεοελληνικής κοινής. Μετάφραση Κ. Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα, σελ.,170.

¹¹ Κλαίρης Χρήστος – Μπαμπινιώτης Γεώργιος. 1996. Γραμματική της Νέας Ελληνικής. Το ρήμα. Δομολειτουργική, επικοινωνιακή: Η οργάνωση του μηνύματος. Αθήνα: Ελληνικά Γράμματα, σελ., 172-173.

¹² Κλαίρης Χρήστος – Μπαμπινιώτης Γεώργιος. 1996. Γραμματική της Νέας Ελληνικής. Το ρήμα. Δομολειτουργική, επικοινωνιακή: Η οργάνωση του μηνύματος. Αθήνα: Ελληνικά Γράμματα, σελ., 173-174.

¹³ Isacenko, vep. e cit , f. 348.

mënyrat e konsiderimit të kohës së foljes, kohën dhe aspektin e foljes, i cili është i njohur dhe me termat pamje, paraqitje, aspekt.

Përveç pozicionimit në aksin kohor, çdo ngjarje ka dhe përbërjen e saj të brendshme kohore. Përbërja e brendshme kohore e ngjarjeve quhet aspekt leksiko - kohor. Përbërja kohore objektive deklarohet automatikisht nga kuptimi i foljes, por folësi ka mundësi të shfaqë / të deklarojë mënyrën me të cilën ai vetë përballet me ngjarjen, përta i përket përbërjes kohore, këndvështrimin me të cilin ai e vështron këtë ngjarje.

Folësi ka mundësi që përveç përbërjes kohore të shfaqë dhe mënyrën me të cilën ai vetë përballet me ngjarjen pra të shprehë dhe këndvështrimin me të cilin e vështron ngjarjen: në mënyrë të përmbledhur apo në zhvillim e sipër. Ky diferencim shprehet me trajtën e foljes, me dy temat kryesore të foljes, temën e kohës së tashme, temën e kohës së kryer të thjeshtë. Me temën e kohës së tashme formohen trajtat e vazhdueshme dhe me temë e kohës së kryer të thjeshtë ato momentale /çastore.

Përfundime.

- Kategoria e aspektualitetit mund të konsiderohet universale, sepse bota që na rrethon është e njëjtë për të gjithë dhe çdo fragment i saj mund të përshkruhet me mjetet e secilës gjuhë. Këtë realitet gjuhë të ndryshme e “gjymtyrojnë” në mënyra të ndryshme.
- Aspekti përbën mënyrën e zhvillimit të veprimit në kohë. Mjetet e shprehjes formale janë: morfologjike, sintaksore, leksikore dhe çdo kombinim i mundshëm i tyre me elementët e kontekstit ose të situatës ligjërimore.
- Kategoria e aspektualitetit mund të konsiderohet universale, sepse bota që na rrethon është e njëjtë për të gjithë dhe çdo fragment i saj mund të përshkruhet me mjetet e secilës gjuhë. Këtë realitet gjuhë të ndryshme e “gjymtyrojnë” në mënyra të ndryshme.
- Gjuha shqipe dallon nga gjuha greke për nga mënyra e organizimit strukturor të aspektualitetit, për nga prania /mungesa e njërit apo tjetrit komponent përbërës. Gjuha greke ka në qendër të saj kategorinë gramatikore të aspektit foljor, gjuhës shqipe ky komponent i pastër gramatikor i mungon. Në gjuhën shqipe nuk është zhvilluar kategoria e aspektit foljor. Për rrjedhojë nuk mund të bëhet fjalë për aspect perfektiv / imperfektiv.
- Më afër midis shqipes dhe greqishtes qëndrojnë kuptimet e veçanta gramatikore. Kuptimet e përgjithshme të formave gramatikore, siç janë edhe kuptimet aspekti i kryer / aspekt i pakryer janë karakteristike për njërën ose tjetrën gjuhë ose për gjuhë gjenetikusht të përtafërta, siç është kategoria e aspektit foljor.
- Mënyrat e veprimit mbështeten në kuptimet leksikore të foljeve dhe shprehen me mjete morfologjike. Për shprehjen e tyre, ndryshe nga greqishtja, shqipja përgjithësisht përdor elementë të kontekstit ose ndërtime analitike dhe më pak ato sintetike.

RRETH KATEGORISË GRAMATIKORE TË ASPEKTIT NË SHQIPE DHE
GREQIShte

BIBLIOGRAFI

- Gramatika e gjuhës shqipe I. 1995. Tiranë: Akademia Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Dharmo, A. 1996. Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "Libri Universitar", Tiranë.
- Fjalor i shqipes së sotme, 2002, *Shtëpia Botuese "Toena"*, Tiranë.
- Κλαίρης Χρήστος – Μπαμπινιώτης Γεώργιος. 1996. Γραμματική της Νέας Ελληνικής. Το ρήμα. Δομολειτουργική, επικοινωνιακή: Η οργάνωση του μηνύματος. Αθήνα: Ελληνικά Γράμματα.
- Mackridge, P. 1985. Η Νεοελληνική Γλώσσα. Περιγραφική ανάλυση της νεοελληνικής κοινής. Μετάφραση Κ. Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα.
- Μπαμπινιώτης, Γ. 2002. Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων, ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων - αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων, με αξιοποίηση του γλωσσικού αρχείου Αθηνών Εκδόσεις: ΚΕΝΤΡΟ ΛΕΞΙΚΟΛΟΓΙΑΣ, Αθήνα.
<http://www.greeklanguage.gr> (διαδικτυακός τόπος του Κέντρου Ελληνικής Γλώσσας).
<http://www.ilsp.gr> (διαδικτυακός τόπος του Ινστιτούτο Επεξεργασίας του Λόγου).

Abstrakt

Në këtë kumtesë në mënyrë të përmbledhur jemi përpjekur të pasqyrojmë se si është trajtuar aspekti foljor duke filluar që nga lashtësia me Stoikët, Aristotelin duke iu referuar më pas gjuhëtarëve shqiptarë si p.sh., K. Cipo, S. Floqi, E. Lafe etj., si dhe atyre të huaj. Në qendër të punimit tonë ndodhet mënyra e organizimit strukturor të aspektualitetit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke duke e parë atë në një rrafsh përfaqësues. Kemi analizuar mjetet morfologjike, sintaksore, leksikore të shprehjes formale të aspektualitetit dhe çdo kombinim të mundshëm të tyre me elementët e kontekstit ose të situatës ligjërimore.